



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivory	23 - 08 2023	3 viti god. year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOK	5786/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.994/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.994/2023, të datës 14.07.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted] kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik në çështjen juridike " Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 23.08.2023, mori këtë

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.994/2023, e datës 14.07.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] me datë 14.07.2023, me numër protokolli 5250/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore lidhur refuzimin e aplikacionit në lidhje me zhvillimin e procedurës së rekrutimit nga Ministria e Punëve të Brendshme/ Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik për pozitën „ Inspektor në Fushën e Arsimit”, për grupin Specialist të Arsimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.07.2023, përmes e-mailit e ka proceduar kërkesën për përgjigjen në ankesë te Ministria e Punëve të Brendshme Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik. Ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura më datë 18.07.2023 dhe të protokolluar në këshill më datë 03.08.2023.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.994/2023 e parashtruar më datë 14.07.2023, me numër protokollin 5250/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjja në ankesë me numër protokollin 994/2023, e datës 03.08.2023 Licenca e datës 24.10.2019; vendimi Nr.44/2023 i datës 10.07.2023 i DMZP-së.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e administruar rrjedhë se Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik më datë 05.05.2023 ka publikuar konkursin me numër reference RN00011607, për emrin e grupit "Specialist të Arsimit".

Me tej nga shkresat e kësaj çështje rezulton, së në konkursin më numër reference RN00011607, ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo të njëjtit me Vendimin Nr.44/2023 të datës 10.07.2023 të Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik/Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit i është refuzuar aplikacioni me Nr.kodi RAN0015147 i datës 05.06.2023, më arsyetimin së ankuesi nuk ka ofruar licencën e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës ashtu si ka qenë e paraparë në konkurs.

Pas vendimit lidhur me refuzimin e aplikacionit, ankuesi ka parashtruar ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se i është mohuar e drejta të jetë pjesëmarrës i këtij konkursi, duke pranuar faktin se i njëjti nuk ka ngarkuar licencën sepse ka qenë e skaduar dhe Ministria e Arsimit nuk ka gjeneruar të reja, kjo gjithnjë sipas ankuesit mund të vërtetohet në MASHT.

Lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, Kolegji i Këshillit mori parasysh dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 15 paragrafi 5 dhe 6 të më të cilat është përcaktuar se: "...5. Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6. Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj..." si dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të më të cilin parashihet se: 1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli"). 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet..." dhe si rrjedhojë mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton faktin se kandidati të cilit i është refuzuar aplikacioni për shkak të mos plotësimit të kushteve për pozitën e shpallur, fillimisht



duhet të ushtroj ankesë të brendshme të Njësia e Burimeve Njerëzore, e me tej mund të ushtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, nisur nga ky konstatim dhe meqenëse me asnjë provë të parashtruar nga palët në procedurë nuk vërtetohet se ankuesi ka kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit për refuzimin e aplikacionit, përmes ushtrimit të ankesës së brendshme të Njësia e Burimeve Njerëzore, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit A.nr.994/2023 e datës 14.07.2023, e parashtruar drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e palejueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si ma lartë, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.994/2023, datë 23/08/2023.

**Avdyll BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB
- Udhëheqësit të Divizionit për Zhvillimin e Regrutimit dhe Inspektimit-MPB-DMZP,dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së